AKT THEMELIMI

I SHOQERISE PRODHUESE E TREGETARE ME EMERTIMIN

"LINEKXA" sh.p.k.

I hartuar ne baze te mareveshjes se paleve si me poshte vijon:

I.APOSTOLOS KUTRAS, i biri i Nikolas, dt 1943, shtetas grek

2.PANAJOT DHEFTO i biri i Theodhoriut, dt 1957, lindur dhe banues ne Pesh-kepi.

3.DHIMITER PAPA i biri i Ilias, dt 1966, lindur ne Llongo dhe banues ne Gjirokaster

Ne baze te ligjit 7512 dt 10.8.1991 dh ligjit 7638 date 19.11.1992 ne ku-chtet si me poshte vijon:

Neni 1

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufituar si person juridik privat per te ushtruar veprimtrai private ne pajtim me ligjin dhe me qellime fitimprurese per te.

Neni2

EMERTIMI i shoqerise eshte "LINEKXA" sh.p.k.

Neni 3

QENDRA E VEPRIMTARISE se shoqerise eshte ne fshatin Gline ku do te kete dhe SELINE e saj.

Neni 4

OBJEKTI i veprimtarise se shoqerise eshte veprimtaria ne fushen e pro-dhimit, perpunimit e tregetimit te letres ne lloje te ndryshme te saj s leter higjenike, kartpeceta etj, te produkteve te ndryshme plastike dhe lendeve per pastrim. Veprimtrari ne fushen e tregetise se pergjitheshme import eksport, ne fushen e transportit te produkteve e lendeve te para si dhe cdo veprimtari tjeter te lejuar nga ligji per te cilen palet do te bien dakort.

Neni 5

AFATI i veprimtarise se shoqerise eshte 20 vjet

Neni 6

KAPITALI baze i shoqerise eshte 100.000 leke i cili do te krijohet me kontributin e paleve si me poshte: Zoti Apostolos Kutras do te kete 66 te tij, zoti Panajot Dhefto dhe zoti Dhimiter Papa do te kene nga 17 % ketij kapitali. Palet nuk kufizohen ne shtimin e kapitalit.

Neni 7

Organi me i larte i shoqerise eshte mbledhja e ortakeve, ose asambleja rregullat e mbledhjes se te ciles percaktohen ne Statutin e shoqerise

Neni 8

ADMINISTRATORI i shoqerise eshte zoti Apostolos Kutras per pese vitet para. Pas pese vitesh zgjedhja e administratori te ri behet me vendim mbleje me shumice votash.

Neni 9

Per shkelje te kryera prej tij te Statutit dhe ligjit dhe per deme t

shkaktuara gjithashtu prej tij pergjigjet ne menyre individuale sipas ligjit.

Neni IO

Shoqeria mund te punesoje edhe punonjes per ushtrimin e veprimtarise se saj ne baze te rregullave te percaktuara ne Statut dhe ka per detyre te beje sigurimin e tyre prane Deges se Sigurimeve Shoqerore.

Neni II

Pjeset e kapitalit jane teresisht te transferueshme me miratim te paleve Gjithashtu lejohet shitja e pjejes se tyre te ortaku i mbetur gjithmone ne cmim me te larte.Menyrat e transferimit percaktohen ne ligjin 7638 dt I9.II.1992,neni 16 i tij.

Neni I2

Asambleja si rregull mblidhet tre here ne vit.Te drejten e thirrjes se saj e ka Administratori ose perfaqesuesi i tij,i cili lajmeron ortaket per rrendin e dites I5 dite perpara.

Neni I3

Asambleja vendos per
zgjedhje dhe shkarkim te administratorit
ndryshimin te kapitalit te shoqerise
shnderim te formes se shoqerise
krijimin e degeve dhe filjaleve te saj
bashkime me shoqeri te tjera
blerje,shitje,dhenie me qira te pasurive te shoqerise
miratim te organikes se punonjesve
transferimin e selise se saj
shperndarjen e shoqerise
likujdimin e saj
miratimin e raporteve vjetore
miratimin ose shkarkimin e eksperteve kontabel etj

Neni I4

Administratori e perfaqeson shoqerine para cdo personi juridik e pri[...] para cdo enti publik e shteteror e cdo gjykate.Administratori ka te [...] jten e moskundershtimit nga ortaket e tjere te veprimeve te perdites[...] qe perfshijne operacione normale te punes se shoqerise.Ai pergjigjet[...] per sigurimin e pasurise se shoqerise.

Neni I5

Personat e punesuar ne shoqeri meren me kontrate pune.Paraprakisht [...] nohen ne pune edhe ortaket qe deshirojne te behen ortake.Te ardhurat [...] sigurohen nga puna e tyre nuk perfshihen ne fitimin e tyre por kons[...] ohen si te ardhura suplementare.

Neni 16

Kontabiliteti i shoqerise do te mbahet ne baze te ligjit 7661 dt 19[...] 93"Per kontabilitetin".Financieri i shoqerise qe emerohet dytyrohet[...] kryeje te gjitha kopetencat e ngarkuara nga mbledhja e shoqerise.

Neni I7

Bilanci i shoqerise nxirret ne daten 31 dhjetor te cdo viti. Ai nxirret nen kujdesin e administratorit dhe perfundimi i tij nenshkruehet nga ortaket ne shoqeri.

Neni I8

Fitimi qe do te rezultoje nga aktiviteti i shoqerise do te ndahet sipas pjeseve te seicilit prej ortakeve ne kapitalin themeltar. Palet pergjigjen per humbjen qe do te pesoje shoqeria sipas perqindjeve te tyre ne kapitalin themeltar dhe ne baze te kontributit.

Neni I9

Fitimi do te ndahet pasi me pare te jene zbritur te ardhurat dhe gjithe shpenzimet e shoqerise si tatime taksa,pagat e punonjesve si dhe shpenzime te tjera.

Neni 20

Palet me pelqimin e tyre dhe me vendim te asamblese te shoqerise mund te bien dakort qe te krijojne fondin rezerve i cili do te sherbeje per kapitalizimin te fitimeve,per perballimin e nevojave te jashte zakonshme per shtimin e aftesive kredimarese te saj.Ky fond eshte i detyrushem te behet deri sa te arije ne masen 1/20 e kapitalit te shoqerise

Neni 2I

Shoqeria nuk do te nderprese aktivitetin e saj nese ajo falimenton ose njeri prej ortakeve eshte deklaruar i paafte per te ushtruar veprimtari private dhe kjo e drejte nuk i eshte hequr ne baze te ligjit.Trashegimtaret e ortakut qe nuk eshte me kane te drejte te largohen nga shoqeria duke patur te drejten e shitjes se pjeses se tyre ne kapitalin baze te shoqerise apo dhe ne fitime.

Neni 22

Te drejten e marjes ne pune dhe largumit nga puna per shkelje te disiplines ne pune e ka vetem administratori,kopetencat e te cilit janeparashikuar me hollesisht ne Statutin e shoqerise

Neni 23

Fitimi qe do te rrezultoje do te ndahet ne baze te pjeseve te ortakeve ne kapitalin themeltar.
Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te fitimeve ortaket themelues ose asambleja e ortakeve percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividenteve. Fitimi qe do tu ndahet ortakeve perbehet nga fitimi i vitit financiar,te cilit i jan zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem(i cili perbehet nga 5% e fitimit te cdo viti deri sa ky fond arin vleren I/IO pjese te kapitalit themelor) dhe nga ana tjeter te jene zbritur ose te jene shtuar respektivisht humbjet ose fitimet e viteve te meparshme.

Neni 24

Shoqeria nuk pergjigjet per humbjet e ortakeve jashte veprimtarise se

shoqerise.

Shxteti nuk pergjigjet per humbjet e shoqerise dhe anasjelltas.

Neni 25

Pranimi i ortakeve te rinj do te behet me miratim unanim te paleve dhe ne baze te rregullave qe jane percaktuar ne sxtatutin e kesaj shoqerie.

Neni 26

Seicila nga palet ka te drejte teklargohet nga shoqeria para mbarimit te afatit te parashikuar ne kontrate,pasi me pare te kete njoftuar administratorin e shoqerise gjashte muaj me pare me shkrim.

Neni 27

Vendimet lidhur me pranimin e ortakeve te rinj,ndryshimin e qendres se shoqerise,ndryshime ne kapital,krijimin e degeve dhe filialeve etj probleme qe kane te bejne e organizimin e shoqerise jane parashikuar shprehimisht ne Statitin e Shoqerise.

Neni 28

Seicila nga palet detyrohet te veproje ne menyre te denje dhe te sinqerte ne shoqeri,dhe ne rast se me veprimet e tij ortaku i ka sjelle dem shoqerise asi detyrohet te ndemtojex demin e shkaktuar dhe te pagu aje nje gjobe 100 % te demit

Neni 29

menyra e zgjidhjes se mosmareveshjeve dhe e likujdimit te shoqerise percaktohet shperhimisht ne nenet e Statutit te shoqerise.

Neni 30

Akti i themelimit u hartua nga ortaket dhe perpilohet ne tre kopje

ORTAKET:APOSTOLOS KUTRAS PANAJOT DHEFTO DHIMITER PAPA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE GJIROKASTER NR 18 REP

V E R T E T I M

Sot ne daten 6.1.1996,para meje noteres Firdes Shuli u paraqiten personat pale ne kete akt themelim,per identitetin e te cileve u njoh jta ne baze te ligjit,qe kerkuan dhe nenshkruan se kane hartuar kete akt themelimi me vullnetin e tyre.Une bej legalizimin e nenshkrimeve

APOSTOLIS KUTRAS PANAJOT DHEFTO DHIMITER PAPA

NOTERE
FIRDES SHULI

REPUBLIKA E SHQIPERISE FIRDES SHULI NOTERE GJIROKASTER

# S T A T U T
## I SHQQERISE PRODHUESE E TREGETARE
## "LINEKXA"sh.p.k.

Me cilesine e themeluesve te shoqerise prodhuese tregetare"LINEKX"sh.p.k ne te nenshkruarit:
I.APOSTOLOS KUTRAS i biri i Nikolas,dt I943,lindur ne Kumani Ilias Greqi dhe banues ne Patra Greqi,
2.PANAJOT DHEFTO i biri i Theodhoriut,dt I957,lindur dhe banues ne Peshkopi Gjirokaster.
3DHIMITER PAPA i biri i Ilias,dt I966,lindur ne Llongo e banues ne Peshkopi Gjirokaster,
kemi hartuar statutin e shoqerise si dhe aktin e themelimit bashkangjitu kesaj shoqerie dhe ketij statuti.--
Statuti eshte hartuar ne keto nene si me poshte vijon:

I

Neni I

Krijohet shoqeria prodhuese tregetare me karakter juridik,me emertimin "LINEKXA"sh.p.k,ne perputhje me legjislacionin e shtetit shqiptar ne fuqidhe dispozitat e mareveshjes shqiptaro greke te ketij statuti.

Neni 2

OBJEKTI i veprimtartise te kesaj shoqerie eshte Veprimtraria ne fushen e prodhimit,perpunimit e tregetimit te:letres se llojeve te ndryshme si leter higjenike etj,te produkteve te ndryshme plastike dhe lendeve per pastrim.Veprimtrati ne fushen e tregetise se pergjitheshme import eksport,ne fushen e transportit te produkteve e lendeve te para,si dhe cdo veprimtrai e lejuar nga ligji per te cilen palet do te bien dakort.

Neni 3

SELIA e shqoerise eshte ne fshatin Gline ku do tejete dhe qendra e veprimtarise se saj.Shoqeria ka te drejte te krijoje dege e filiale dhe ne vende te tjera.Transferimi i selise behet me miratim te ortakeve,atyre ekzistues ose qe mund ti shtohen,kur zoterojne mbi nje te dyten pjese te kapitalit te shoqerise.

Neni 4

KOHESZGJATJA e veprimtraise se shoqerise eshte 20,njezet,vjet duke filluar nga dita e rregjistrimit si person Juridik.Kjo shoqeri mund te zgjase afatin e aktivitetit te saj ose ta mbylle ate me pare me vendim te ortakeve dhe ne kushtet e parashikuara nga ligji.

Neni 5

ADMINISTRATORI i shoqerise eshte zoti Apostolos Kutras.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte IOO.OOO,njeqind mije,leke dhe me karakter plotesisht te shlyeshem.Fondet qe rrjedhin nga shlyerja e pjeseve qe depozitohen ne banken e shtetit Shqiptar,per llogarine e shoqerise se krijuar.Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet tejshtimit te

pjeseve te reja,ortaket kane te drejten e perparesise se nenshkrimit
proporcionalisht me shumen e pjeseve te tjera,por jane te lire te he-
qin dore nga kjo e drejte apo te vendosin transferimin apo shitjen te
te tjeret,ne cmime gjithmone me te larta qe do te ofrohen nga ortaku i
mbetur .
Shoqeria mund te zmadhoje ose te zvogeloje kapitalin e saj.Ndryshimet
ne kapitalin themeltar behen nga asambleja e ortakeve,me shtimin e orta
keve,me shumicen e ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar qe zoterojne
tre te katretat pjese te kapitalit themelor.Zvogelimi i kapitalit i
prek te gjithe ortaket ne te njejten mase.

Neni 7

KAPITALI THEMELTAR i shoqerise eshte I00.000 leke,formohet nga kontri-
buti i seicilit ortak dhe konkreteisht:Zoti Apostolos Kutras 66 % e ka-
pitalit,zoti Panajot Dhefto I7 %,dhe zoti Dhimiter Papa I7 %.Ne vlefte
leku i pari 66.000 leke,i dyti I7.000 leke dhe i treti I7.000 leke.
Pjeset jane te disponueshme dhe ndahen nga numri nje deri ne njeqind te
serise.Te gjitha pjeset qe formojne kapitalin Themeltar shkruhen dhe
shlyhen plotesisht,pastaj shperndahen ndermjet ortakeve sipas ndarjes
se mesiperme,pasi me pare te jene firmosur nga administratori i shoqeris

Neni 8

Pjest e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie
ne raste ndarje te pasurise ndermjet bashkeshorteve dhe ndermjet pas-
ardhesve dhe paraardhesve.Pjeset e kapitalit Themeltar mund te transfe-
rohen dhe te treteve vetem me miratim te ortakeve themelues ose me mira
tim te 70 % te ortakeve te ardhshem me kushte qe nuk do te jene me te
favorshme nga ato qe u ofrohen ortakeve ekzistues.

Neni 9

Ortaket themelues per sa kohe marin vendime si te tille,vendimet e mara
nga ata njeschen me vendimet e nje asamblaje ortakesh.Ortaket e saj pe-
rballojne humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne
kapitalin themeltar.
Ne rast shtimi te ortakeve,cdo ortak ka te drejte te mare pjese ne mb-
ledhjen e Asamblese se Ortakeve,kur disponon qofte edhe nje pjese te
kapitalit themeltar qe ai zoteron.Ne ushtrimin e nje te drejte cdo or-
tak ka te drejte te perfaqesohet nga nje perfaqeuses tjeter me prokure
perfaqeimi ne baze te ligjit.
Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga nje ose disa ortake qe zotero
jne mbi tre te katartat pjese te kapitalit themeltar,nga administrato-
ri,nga ekspertet kontabel te autorizuar,ose nga likujduesit kur shoqeria
eshte ne procesin e mbylljes se aktivitetit.

Neni IO

Sipas rendesise se vendimeve,mbledhja e asamblese mund te jete e zako-
nshme ose e jashtezakonshme.Asambleja e zakonshme vendos per ceshtje te
tilla si emerimi ose shkarkimi i Administratoreve,eksperteve kontabel
dhe likujadtoreve,miratimin e llogarive vjetore dhe ndarja e fitimit.

Asamblja e jashtezakonshme vendos per ceshtje te tilla si ndryshimi i statutit,zvogelimi i kapitalit themeltar,transferimi i pjeseve te ti, te te tretet,zgjatja e kohes se veprimtarise se shoqerise apo likujdimi i saj,shnerrimi i shoqerise me pergejegjesi te kufizuar ne shoqeri me forma te tjera etj.

Neni II

Asambleja e zakonshme ne mbledhje,mund te mare vendime te vlevshme ne qoftese jane te pranishem ose te perfaqesuar nje numer ortakesh qe zoterojne nje te dyten e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqrise dhe vendimet meren me shumice votash.Ne se mbledhja e pare e Asamblese se Zakonshme nuk realizohet thirret mbledhja e dyte e cila mund te mare vendime te vlefshme,pamvaresisht se sa pjese te kapitalit themeltar zoterojne ortaket e pranishem ose te perfaqesuar dhe vendimet meren me nje shumice votash mbi nje te dyten e ortakeve te pranishem ose te perfaq.

Neni I2

Asambleja e jashte zakonshme ketkon kushte prezence ose perfaqesimi te njejta me ato te asamblese se zakonshme,si ne mbledhjen e pare ashtu dhe ne te dyten,por ajo mer vendime me shumice votash.-

Neni I3

Shoqeria administrohet nga nje administrator,i cili per pese vitet e para eshte ortaku Apostolos Kutras.Administratoret miratohen ose shkarkohen me miratimin e ortakeve themelues ose 50 % te ortakeve qe zoterojne nje vlere te lapitalit themelor ne momentin kur zgjidhet administratori Administratori ka te drejte te jape doreheqie ose te shkarkohet perkohosisht.Administratori ka kopetence per te kryer te gjitha veprimet e administrimit direkt ose nepermjet te deleguarit te tij,ne interes te shoqerise ose ne emer te saj,nepermjet akteve qe jane ne perputhje me me objektin e shoqerise,me perjashtim te atyre kopetencave qe ligji dhe statuti ua jep anetareve themelues ose shprehimisht asamblese.

Administratori ose personat e ngarkuar prej tij jane pergjegjes direkt per shkeljet ligjore dhe ato te parashikuara ne aktin e themelimit te shoqerise qe vijne ne kundershtim me interesat e shoqerise dhe i shkaktojne deme asaj e te treteve.

Administratori ka te drejte ti jape nje pjese te kopetencave tetij nje ortaku ose nje personi tjeter nepermjet nje akti oerfaqesimi me shkrim.

Neni I4

Ne raste nevoje,kontrollimi shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar,i emeruar per tre vite financiare,me mundesi rrizgjedhjeje nga shumica e ortakeve qe perfaqesojne mbi nje te dyten e kapitalit themeltar.Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi ,ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

Neni I5

Cdo vit financiar fillon ne janar dhe perfundon ne fund te vitit.Viti i pare financiar fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise dhe perfundo

on ne 3I dhjetor I997.

Llogarite vjetore,iventari,raportet mbi operacionet e vitit financiar d
dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eksperti kon-
tabel i autorizuar,miratohen nga asambleja me shumicen e ortakeve qe
zoterojne mbi nje te dyten pjese te kapitalit themeltar.
Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati
prej gjashte muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni I6

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te fitimeve ortaket
themelues ose Asambleja e ortakeve percakton pjesen qe u takon ortakeve n
ne formen e divideteve.Fitimi qe do te ndahet ndermjet ortakeve ne pro
porcion me pjeset e kapitalit themeltar perbehet nga fitimi i vitit fina-
nciar,te cilit i jan zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te
domosdoshem(5 % e fitimit te cdo viti deri sa ky fond arrin vleren I/IO
pjese te kapitalit themeltar dhe nga ana tjeter jane zbritur ose jane
shtuar respektivisht humbjet ose fitimet e viteve te meparshme.

Neni I7

Afati i percaktuar ne kete statut mund te zgjatat nga ortaket aktuale
ose nga asambleja me shumicen e atyre qe zoterojne 1/2 e pjeseve te kapi
talit themeltar.

Neni I8

Shoqeria prishet me perfundimin e afatit me perjashtim kur behet zgjatja
e afatit ose prishje e parakohshme e saj ne rastet e parashikuara ne sta
tut.Shoqeria nuk prishet edhe kur ortaket(ose njeri prej tyre) themelues
falimentojne,behen te paafte ose vdesin.

Neni I9

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e likujdimit te saj
Per kryerjen e ketij problemi,procesi emerohet nje ose disa likujdues
te cilet i paraqesin asaj rraportin mbi gjendjen e aktivitetit,aktivit
dhe pasivit te saj,mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afa-
tin e nevojshem te perfundimit te tyre.
Ne perfundim te likujdimit shumica e ortakeve themelues,ose asambleja
vendos me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi nje te dyten pjese te ka-
pitalit themeltar,bilancin perfundimtar financiar mbi aktin e rregullshme
rise se punes se likujduesit dhe me mbylljen e procesit te likujdimit.
Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit the-
meltar te kontribuesit perkates,proporcionalisht me pjeset qe ata zote-
rojne ne kapitalin themeltar,mbyllet shoqeria.

Neni 20

Mardheniet e punes midis shoqerise dhe te punesuarve do te percaktohen
nga kontratat individuale si dhe nga kontrata kolektive e punes.Per ato
qe nuk parashikohen ne keto kontrata zbatohen dispozitat e Kodit te Punes

Neni 2I

Te gjitha mosmareveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise
ose zgjatja e periudhes se likujdimit,ndermjet shoqerise dhe personave

juridik apo fizik,do tia paraqesin per zgjidhje gjykates se rrethit Gjirokasrer apo dhe cdo gjykate te Evropes.

Ky statut eshte hartuar mbi bazen e vullnetit te ortakeve themelues.Per sa kohe qe ne veprimtartine e tyre nuk ka shmangie nga detyrimet qe rrjedhin nga kontrata dhe statuti i shqqerise,percaktimet qe sanksiono-hen ne aktet e themelimit te saj jane te vlevshme me aktet ligjore te karakterit normativ.Ky statut hyn ne fuqi ne fillim te aktivitetit te shoqerise pasi te rregjustrohet ne organet tatimore e financiare.

Neni 22

Statuti shtypet ne tre kopje.Ortket e shqoetise pasi u njojten me permbajtejen e ketij stetuti e nenshkruajne sot ne daten 3.I.I997.

ORTAKET THEMELUES

APOSTOLOS KUTRAS PANAJOT DHEFTO DHIMITER PAPA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMAE NOTEREVE
GJIROKASTER

NR 18 REP

V E R T E T I M

Sot ne daten 3.I.I997,para meje noteres Firdes Shuli u paraqiten te quajturit Apostolos Kutras,shtetas grek qe mban leternjoftimin me nr M4II268,dhe Panajot Dhefto e Dhimiter Papa,banuesa ne Peshkepi Gjirokaster persona te njojtur nga une noteria te cilet me vullnetin tyre te lire nenshkruajne duke pranuar qe statuti i mesiperm eshte shprehje e vullnetit te tyre te lire.Une noteria bej vertetimin e nenshkrimeve te tyre

Gjirokaster me 3.I.1997

APOSTOLOS KUTRAS PANAJOT DHEFTO DHIMITER PAPA

NOTERE
FIRDES SHULI

REPUBLIKA E SHQIPERISE FIRDES SHULI NOTERE GJIROKASTER